

VENDIM
Nr. 342, datë 5.6.2024

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 359, DATË 16.6.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË URËS NË LEZHË DHE CAKTIMIN E
BASHKISË LEZHË SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 359, datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Bashkisë Lezhë, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i transferohet fondi, në masën 151 838 708 (njëqind e pesëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku